

FINANCA

Ditari Mujor | Janar 2024



Ministri Mete, konferencë për shtyp për arritjet e vitit 2023 dhe parashikimet për 2024

Ministri i Financave, Ervin Mete, prezantoi disa nga arritjet kryesore ekonomike për vitin 2023 dhe parashikimet për vitin 2024, në konferencën e parë për shtyp për vitin aktual. Ministri u shpreh se viti 2023 ishte pozitiv për ekonominë dhe financat e vendit, duke u karakterizuar nga performanca pozitive e mbledhjes së të ardhurave, rritja e investimeve të huaja direkte, zhvillimet pozitive në sektorin e turizmit, përmirësimi i bilancit tregtar dhe ulje e papunësisë. Sa i përket vitit 2024, Ministri informoi se do të vijohet me rritjen e pagave në sektorin publik, ndërsa parashikohet që ekonomia të vijojë zgjerimin e saj. Ministri theksoi se rritja e mëtejshme ekonomike do të mbështetet nga buxheti i vitit 2024, i cili parashikon 7 miliardë euro shpenzime publike të planifikuara, zbritje të borxhit publik në nivelin 60% dhe mbi 634 miliardë lekë të ardhura tatimore të parashikuara.

▶ LEXO MË SHUMË



Ministri Mete me Ambasadorin e BE-së, diskutim mbi vijimin e reformave dhe përshejtimin e procesit të integritimit

Ministri i Financave, z. Ervin Mete, priti në një takim ambasadorin e Bashkimit Europian në Tiranë, z. Silvio Gonzato. Gjatë takimit u diskutua mbi ecurinë e procesit të negociatave Shqipëri-BE, Planin e Rritjes për vendet e Ballkanit Perëndimor, si edhe mundësitë për thellimin e mëtejshëm të bashkëpunimit. Palët nënvizuan ecurinë e mirë të ekonomisë shqiptare dhe rezistencën e shfaqur ndaj një sërë goditjesh. Në kuadër të procesit të reformave dhe integritimit të vendit në Bashkimin Europian, Këshilli i Ministrave miratoi në muajin janar edhe Programin e Reformave Ekonomike (ERP) 2024 - 2026, si një dokument të rëndësishëm për vijimin e procesit të integritimit në BE..



Ministri Mete me Investitorët e Huaj: Mbyllëm një vit pozitiv! Angazhim të përmirësojmë më tej klimën e biznesit

Ministri i Financave, Ervin Mete, mori pjesë në pritjen e organizuar nga Shoqata e Investitorëve të Huaj

në Shqipëri (FIAA), ku gjatë fjalës së tij vlerësoi se viti 2023 shënoi një moment të rëndësishëm për ekonominë e vendit dhe pritshmëritë për vitin 2024 janë pozitive. Ministri theksoi rëndësinë e forcimit të bashkëpunimit me biznesin me qëllim për të çuar përpara perspektivën e ekonomisë shqiptare dhe përmirësuar më tej klimën e biznesit. Ndërsa pohoi se përmirësimi i mëtejshëm i klimës së biznesit mbetet prioriteti i vazhdueshëm, Ministri tha se duhet bërë më shumë për rritjen e produktivitetit dhe kapitalin njerëzor, të cilat ndihmojnë për një klimë më të mirë biznesi. Nga ana tjetër, Ministri informoi se së shpejti pritet të ketë një rivitalizim të Këshillit Tatimor, si një platformë diskutimi mes qeverisë dhe biznesit.

▶ LEXO MË SHUMË



Ministri Mete takohet me të Ngarkuarin me Punë në Ambasadën e SHBA-ve në Tiranë, z. David Wisner

Ministri i Financave, z. Ervin Mete, priti në një takim zyrtar të Ngarkuarin me Punë në Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë, z. David Wisner.

Në takim u diskutua mbi mundësitë për rritjen e bashkëpunimit ekonomik mes Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara Amerikës. Ministri Mete vlerësoi mbështetjen që SHBA-të kanë dhënë dhe vijojnë të japin për zbatimin e reformave të rëndësishme për vendin. Mete u shpreh se qeveria shqiptare mirëpret rritjen e investimeve amerikane në Shqipëri në sektorë të ndryshëm të ekonomisë. Bashkëbiseduesit theksuan rëndësinë për të thelluar më tej bashkëpunimin dhe marrëdhëniet mes dy vendeve, edhe si aleatë në NATO. Në këtë drejtim, i Ngarkuari me punë në Ambasadën e SHBA-ve në Tiranë, z. Wisner shprehur gatishmërinë për të vijuar mbështetjen për Shqipërinë, e cila në buxhetin e vitit 2024 për sektorin e mbrojtjes arriti për herë të parë 2% të GDP-së si angazhim ndaj NATO-s.

▶ LEXO MË SHUMË



Ministri Mete takon Menaxherin e Bankës Botërore dhe ekipin e sektorit financiar, diskutohet rritja e aksesit në financë

Ministri i Financave, z. Ervin Mete, zhvilloi një takim me Menaxherin e Zyrës së Bankës Botërore në

Shqipëri, z. Emanuel Salinas, së bashku me ekipin e BB për Sektorin Financiar. Në takim u diskutua mbi mundësitë e bashkëpunimit dhe asistencës së Bankës Botërore në drejtim të zgjerimit të aksesit në financë, me fokus zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të bujqësisë dhe ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM). Palët theksuan rëndësinë e rritjes së edukimit financiar dhe aksesit në financë, si dhe ranë dakord të vijojnë diskutimet në drejtim të gjetjes së mundësive për të lehtësuar financimin për fermerët dhe NMVM-të. Lidhur me këtë, palët diskutuan rreth instrumenteve alternative të financimit, si edhe mundësitë për zgjidhje inovative për mobilizimin e financave të gjelbra dhe dixhitale.

▶ LEXO MË SHUMË



Ministri Mete takohet me Ambasadorin e Mbretërisë së Holandës, diskutime mbi marrëdhëniet ekonomike dhe zgjerimin e investimeve holandeze në Shqipëri

Ministri i Financave, z. Ervin Mete, priti në një takim zyrtar Ambasadorin e Mbretërisë së Holandës në Tiranë, z. Reinout Vos, me të cilin diskutoi mbi marrëdhëniet ekonomike mes dy vendeve dhe mundësitë për zgjerimin e investimeve holandeze në Shqipëri. Ministri Mete shprehur vlerësimin për mbështetjen e dhënë nga qeveria holandeze në kuadër të reformave në një sërë sektorësh dhe sa i përket procesit të integritimit, përmes asistencës, financimeve dhe programeve të ndryshme. Ministri pohoi faktin se bashkëpunimi ekonomik dhe tregtar mes Shqipërisë dhe Holandës është rritur në vitet e fundit dhe shprehu angazhimin për thellim të mëtejshëm, ndërsa theksoi mundësitë që ofron vendi ynë në sektorë si agrikultura, turizmi, infrastruktura dhe energjia. Nga ana e tij, Ambasadori z.Vos shprehur interesin e qeverisë holandeze për të intensifikuar marrëdhëniet ekonomike mes dy vendeve dhe për rritjen e prezencës së kompanive holandeze në Shqipëri.

▶ LEXO MË SHUMË



Ministri Mete takohet me Presidentin e Rajonit të Lombardisë, diskutohet zgjerimi i bashkëpunimit dhe investimet italiane në Shqipëri

Ministri i Financave zhvilloi një takim me Presidentin e Rajonit të Lombardisë në Itali, z. Attilio Fontana, së bashku me delegacionin që e shoqëronte. Gjatë këtij takimi u diskutua mbi bashkëpunimin ekonomik mes Shqipërisë dhe Italisë, në veçanti me rajonin e Lombardisë, si edhe mundësinë për rritjen e mëtejshme të investimeve italiane në vendin tonë. Ministri Mete vlerësoi marrëdhëniet shumë të mira ekonomike dhe tregtare mes dy vendeve, si dhe shprehur angazhimin për thellimin e mëtejshëm. Ministri tha se Shqipëria ofron mundësi investimi në shumë sektorë si energji, infrastrukturë, agrikulturë dhe veçanërisht në turizëm, i cili pati një performancë shumë të mirë gjatë vitit të kaluar, duke u kthyer në një prej fushave më atraktive për investimet.

▶ LEXO MË SHUMË